

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga ndërhyrja te Trump te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ramën: I jam mirënjohës nga zemra, pres një gjykim të pandikuar nga
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/nga-nderhyrja-te-trump-te-samiti-i-nato-s-thaci-per-ramen-i-jam-mirenjo-i585331
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 08:42:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 09:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	949b37531abe69f39f24b08de66a06ed0beac7af44f515afa66548a1e281856f
TEKSTI	426b55aac86901a7e7a6503a5aa039af155cd9b8af1748684e345233e1c7a721
PAMJA	a048ac2b10f7ce7230a2491e59c7d9d5dc372a26c55215fa2bcf58d15423e068

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ed85617562ea2d17e88e8a803531ca27cb95d9a40bce5694f043112927730a2e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ed85617562ea2d17e88e8a803531ca27cb95d9a40bce5694f043112927730a2e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e [PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm? Angelina Jolie le pas jetën në SHBA, aktorja zbulon planin e ri: “Dua të jetoj në menyre nomade” Bëtohet para Presidentit, Klodiana Spahiu merr zërin](#)
fundit

Nga ndërhyrja te Trump te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ramën: I jam mirënjohës nga zemra, pres një gjykim të pandikuar nga

11 Shtator 2026, 11:00Politika TEMA



 Nga ndërhyrja te Trump te Samiti i NATO-s! Thaçi për

Ish-presidenti Hashim Thaçi, në intervistën ekskluzive për “Top Story” nga Haga, ka folur edhe për Samitin e NATO-s që do të mbahet në Tiranë.

Ai e konsideron këtë veprim si pikën më kulminante të historisë politike të Shqipërisë.

“Edi e lehtësoi pjesëmarrjen e Kosovës në Bordin e Paqes. Samiti i NATO-së mund të jetë më i vështirë për përpjekjet e tij. Por, edhe Kosova duhet ta ndihmojë vetveten”, theksoi ai.

Grida Duma: Kryeministri Edi Rama i kërkoi Presidentit amerikan Donald Trump, në Bordin e Paqes, të ndërhyjë për të ndalur atë që e quajti “çmenduri” ndaj jush dhe bashkëluftëtarëve tuaj. A prisni një reagim konkret nga SHBA apo nga Presidenti Trump?

Hashim Thaçi: Pres një aktgjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga askush dhe nga asnjë lloj motivi. Të vërtetën e kanë parë gjyqtarët, realitetin e ka parë edhe bota. Tashmë u mbetet atyre të nxjerrin vendimin; është në duart e tyre.

Edi më ka vizituar disa herë. I jam mirënjohës nga zemra. Ai, pikërisht përmes reformave, ka vendosur ta bëjë Shqipërinë evropiane.

Nganjëherë mendoj, duke parë vështirësitë me të cilat ballafaqohet në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, sikur ta jetonin këtë kohë Noli dhe Konica, do ta shpallnin të çmendur, aventurier apo gjenj. Do t'u dukej mision i parealizueshëm.

Dihet ata (Noli dhe Konica) zhvilluan beteja politike, diplomatike dhe mediale; disa i fituan e shumë i humbën. E disa nuk i ndalen deri në frymën e fundit. (raportet dhe ballafaqimet mes tyre, nuk janë objekt i këtij shënimi nga ana ime).

Të gjohtë u munduan për perëndimimizimin e Shqipërisë dhe shqiptareve, por, nga mbetjet me feude lokale u intriguan, u baltosën, u zhgënjyen, u kërcënuan, U DOREZUAN, IKEN dhe nuk u kthyen më.

Edi po e vlerëson besimin qytetar dhe bashkëpunimin me ndërkombëtarët. Po e dëgjon me vëmendje edhe kritikën. Hallall, nuk po dorëzohet përballë vështirësive. Shqipëria po ecën përpara.

Konfirmimi për organizimin e samitit të NATO-së vitin e ardhshëm në Tiranë, krahas anëtarësimit të saj në NATO, është pika kulminante e historisë politike të Shqipërisë. Paraqet besimin e perëndimoreve për progresin e euro-atlantik të saj. Ky fakt duhet të bëjë të ndihet mirë çdo shqiptar.

Pas dështimit të Kosovës për prezencë në samitin e Ankarasë, shpresoj që Edi të gjejë ndonjë hapësirë legale për pjesëmarrje e Kosovës në margjinat e samitit në Tiranë. Edi e lehtësoi pjesëmarrjen e Kosovës në Bordin e Paqes. Samiti i NATO-së mund të jetë më i vështirë për përpjekjet e tij. Por, edhe Kosova duhet ta ndihmojë vetveten.

Grida Duma: Në vitin 2015, Albin Kurti ju kërkoi të mos votohej krijimi i Gjykatës Speciale. Sot, duke parë zhvillimet dhe akuzat e ngritura, a mendoni se ngritja e saj ishte vendim i gabuar?

Hashim Thaçi: Grida, Kosova ishte midis dy zjarresh: të themelonte gjykatën bashkërisht me partnerët ndërkombëtarë, ose të lejonte formimin e saj nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së.

U përcaktua për të keqen më të vogël për Kosovën. Kështu e evitua Rusinë dhe Kinën nga procesi; sikur të ndodhte e kundërta, do të ishte një kthim prapa për Kosovën në kuptimin legal, politik dhe historik.

Për rrethanat thelbësore të ardhjes deri të formimi i kësaj gjykate dhe ecuria e më pastajme, si një proces i gjatë dhe intrigues, nuk mund dhe nuk dua të flas. Isha i zotuar nga ana ime të mos i ndodhte asgjë e keqe Kosovës. Tani jam duke paguar çmimin në lëkurën time. Por, kapërcen edhe kjo vështirësi.

Grida Duma: A keni pasur informacione se Presidenca e Kosovës dhe Presidentja Vjosa Osmani janë kërcënuar për shkak të refuzimit për të lejuar kontrolle nga prokuroria e Hagës?

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Betohet para Presidentit, Klodiana Spahiu merr zyrtarisht detyrën si ministre Shëndetësie](#)

10:33 Politika

[Ndryshimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Rama: Lamallari do të jetë pjesë e ekipit tim në Kryeministri](#)

10:25 Politika

[Besfort Lamallari largohet si ministër i Brendshëm, në vend të tij Ervin Demo](#)

10:10 Politika / 1 koment

[Prestigjozja amerikane Newsweek: Si lufta ligjore kundër Trump-it dhe Veliajt është kthyer në model global](#)

09:45 Politika / 2 komente

[25 vjet nga sulmet terroriste të 11 shtatorit në SHBA, Begaj: Kujtesë kolektive që ka riformësuar jetët tona! Amerika i tregoi botës se nuk mposhtet nga asgjë](#)

09:25 Politika / 1 koment

[Dy reparte ushtarake marrin 271 mln euro investime këtë vit, 37% të buxhetit të mbrojtjes](#)

08:25 Politika / 1 koment

[“S’ka luftë mes qeverisë dhe gjyqësorit”, deputetja e PS: Do miratohet ligji, magistratët të ishin pak më të duruar](#)

21:05 Politika / 14 komente

[Ballat në Paskuqan: 43 shkolla e kopshte të reja në Kamëz, rezultatet e PISA 2025 konfirmojnë transformimin e arsimit](#)

19:25 Politika / 6 komente

[Ambasadori gjerman: Reforma në drejtësi faktor kyç në avancimin e Shqipërisë drejt BE-së](#)

19:15 Politika / 5 komente

['Kallëzim se po zbatohet ligjin', ministri Malaj publikon pagat që kërkojnë magistratët: Efekti në buxhet arrin në 40 milionë euro shtesë çdo vit](#)

19:05 Politika / 70 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

["Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 17 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 24 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "afërën e armëve" m...](#)

15:30 Dossier / 8 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

['Kallëzim se po zbatohet ligjin', ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 70 komente

Blog Tema

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 18 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

• [Politika](#)

• [Sociale](#)

- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.